

LIGJ

Nr. 9663, datë 18.12.2006 i azhornuar

- * Ndryshuar me ligjin nr.9995, date 22.09.2008
- ** Ndryshuar me ligjin nr.10137, date 11.05.2009
- *** Ndryshuar me ligjin nr.10157, date 15.10.2009

PËR KONCESIONET

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është të krijojë kuadrin e nevojshëm për nxitjen dhe lehtësimin e zbatimit të projekteve koncesionare, të financuara nga sektori privat, duke rritur transparencën, barazinë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike.

Ai synon zhvillimin e mëtejshëm të parimeve të përgjithshme në lidhjen e kontratave nga autoritetet publike, nëpërmjet përcaktimit të procedurave të veçanta për dhënien e projekteve koncesionare.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Ofertuesi" ose "Ofertuesit" janë subjekte juridike ose bashkime të tyre, që kanë për qëllim të marrin pjesë apo që marrin pjesë në një procedurë përzgjedhjeje, në lidhje me një koncesion.
2. "Procedurë konkurruese e përzgjedhjes" është procedura për përzgjedhjen e koncesionarit, në përputhje me nenet 10 deri 21 të këtij ligji.
3. "Koncesion" është marrëveshja, pavarësisht nga emri që i jepet, ndërmjet autoritetit

kontraktues dhe koncesionarit, ku përcaktohen kërkesat dhe kushtet e saj dhe në kuptimin e së cilës koncesionari:

a) realizon një veprimtari ekonomike që, në të kundërt, do të kryhej nga autoriteti kontraktues për një projekt koncesioni, kontratë administrimi apo shërbime të tjera publike;

b) merr përsipër të gjitha ose një pjesë thelbësore të rrezikut të lidhur me këtë veprimtari ekonomike;

c) merr një përfitim nëpërmjet:

i) pagesave të drejtpërdrejta nga autoriteti kontraktues apo për llogari të këtij të fundit;

ii) tarifave ose pagesave, që mblidhen nga përdoruesit ose blerësit;

iii) një ndërthurjeje të këtyre tarifave dhe pagesave të drejtpërdrejta.

4. "Koncesionar" është personi juridik, shqiptar ose i huaj, me ose pa pjesëmarrje vendase apo të huaj, që lidh një kontratë koncesioni me një autoritet kontraktues.

5. "Regjistër koncesioni" është regjistri i mbajtjes së të dhënave për procedurën e përzgjedhjes dhe të dhënies së koncesionit, që mbahet nga autoriteti kontraktues dhe që, në fund të procedurës, depozitohet në Agjencinë e Prokurimit Publik. Forma dhe mënyrat e mbajtjes përcaktohen nga kjo agjenci.

6. "Autoritet kontraktues" është autoriteti publik, që ka përgjegjësinë të lidhë kontratë koncesioni.

7. "Mjete infrastrukturore" janë sistemet dhe asetet fizike që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, kryejnë shërbime publike.

8. "Projekt koncesioni" është secila nga veprimtaritë e mëposhtme apo çdo ndërthurje e tyre, si: projektimi, ndërtimi, zhvillimi i mjeteve të reja të infrastrukturës, rehabilitimi, modernizimi apo zgjerimi i mjeteve të infrastrukturës ekzistuese; administrimi, zgjerimi apo shërbime të tjera, që lidhen me mjetet e reja apo ekzistuese të infrastrukturës.

9. "Licencë" është një akt administrativ, që lëshohet nga autoriteti përkatës publik për të ushtruar një veprimtari, bazuar në kritere objektive të kualifikimit.

10. "Koncesione vendore" janë koncesionet për ato veprimtari ekonomike që, në bazë të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, janë kompetencë e njësive të qeverisjes vendore.

11. "Koncesione shtetërore" janë koncesionet për ato veprimtari ekonomike që, në bazë të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, janë kompetencë e njësive të qeverisjes qendrore.

12. "Propozim i pakërkuar" është propozimi për të marrë përsipër projekte koncesioni, i cili nuk ka ardhur në përgjigje të një kërkesë të bërë nga autoriteti kontraktues, brenda kontekstit të një procedure përzgjedhëse konkurruese.

13. "Investim privat" është propozimi, i financuar dhe i realizuar tërësisht nga sektori privat, ku sektori publik nuk merr pjesë drejtpërdrejt apo tërthorazi. Për efekt të këtij ligji, çdo lloj garancie, financiare apo e ndonjë forme tjetër, e dhënë nga sektori publik, vlerësohet si pjesëmarrje e këtij sektori në investimin privat.

***14. "Agjencia e Koncesioneve" është institucion public, e ngritur dhe që funksionon në përputhje me këtë ligj.

15. "Avokati i Prokurimeve" është institucioni i ngritur dhe që funksionon sipas ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik".

16. "Bashkim i përkohshëm i shoqërive" është marrëveshje e shkruar ndërmjet dy ose më shumë personave juridikë, që ka për objekt kryerjen e një veprimtarie të caktuar, ku përcaktohet roli i secilës palë dhe ku njëra prej tyre përcaktohet si shoqëri kryesuese, që përfaqëson bashkimin në nënshkrimin e kontratës dhe në çdo nismë tjetër.

17. "Vlera për para" është një term, që përdoret për të përcaktuar nëse një autoritet kontraktues ka arritur përfitimin maksimal nga mallrat apo shërbimet, që merr dhe/ose jep, në shfrytëzim brenda burimeve që zotëron. Ky term jo vetëm mat vlerën e mallrave apo të shërbimeve, por vlerëson cilësinë, koston, shfrytëzimin e burimeve, përshtatshmërinë me qëllimin, kohën dhe mundësinë për të vendosur që, të gjitha së bashku, të përbëjnë vlerën më të mirë ekonomike.

Neni 3

Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton kushtet, mënyrat, kriteret dhe procedurat e dhënies së koncesioneve në Republikën e Shqipërisë.

**Kur kontrata koncensionare lidhet me perdorimin e nje te mire publike, sipas ketij ligji ajo perfshihet ne kategorine IV.2 te shtojces se ligjit per licensat. Kontratat koncensionare lidhen ne perputhje me dispozitat ne vijim, te ketij ligji. Miratimi ne heshtje nuk zbatohet ne rastin e ketyre kontratave.

Neni 4

Fusha e zbatimit të koncesioneve

1. Ky ligj zbatohet për dhënien e koncesioneve nga autoritetet kontraktuese për veprimtari të ekonomike, në këta sektorë:

- a) në transport (hekurudhat, transportin hekurudhor, portet, aeroportet, rrugët, tunelet, urat, parkimet, transportin publik);
- b) në prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike e të ngrohjes;
- c) në prodhimin, shpërndarjen dhe administrimin e ujit, në trajtimin, mbledhjen, shpërndarjen dhe administrimin e ujërave të zeza, ujitjen, drenazhimin, pastrimin e kanaleve e të digave;
- ç) në grumbullimin, transportimin, përpunimin dhe administrimin e mbetjeve të ngurta;
- d) në telekomunikacion;
- dh) në arsim dhe sport;
- e) në shëndetësi;
- ë) në turizëm dhe kulturë;
- f) në infrastrukturën e burgjeve;
- g) në projektet e riciklimit, rehabilitimit të tokës dhe pyjeve, në parqet industriale, të strehimit, të ndërtesave qeveritare, shërbimeve të mirëmbajtjes së teknologjisë së

informacionit dhe infrastrukturës së bazës së të dhënave;

gj) në shpërndarjen e gazit natyror;

h) në kontratat e administrimit apo në kryerjen e shërbimeve publike, përfshirë edhe ato të sektorëve të sipërpërmendur.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë, autorizon zbatimin e koncesioneve edhe në sektorë të tjerë.

3. Në raste të veçanta, për nxitjen e investimeve në sektorët e përmendur në pikën 1 të këtij neni apo për sektorë të tjerë parësorë në zhvillimin ekonomik të vendit, në përputhje me objektivat strategjike, Këshilli i Ministrave mund t'u ofrojë investitorëve, vendas apo të huaj, koncesione me çmimin simbolik 1 euro. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë, miraton listën e asetëve që do të jepen në koncesion, për efekt të zbatimit të kësaj pike.

4. Ky ligj nuk zbatohet për lëshimin e licencave, përveçse në masën që një licencë lëshohet brenda kuadrit të kontratës së koncesionit.

5. Ky ligj nuk zbatohet për prokurimet publike të shërbimeve, mallrave dhe ndërtimeve, si dhe për investimet private.

*6. Ky ligj nuk zbatohet për projektet, që janë pjese perberese dhe te pandashme te nje projekti, per te cilin, me ligj te vecante, autorizohet Keshilli I ministrave.

Neni 5

Autoriteti kontraktues

1. Autoriteti kontraktues çdo është ministri apo njësi e qeverisjes vendore që, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, është përgjegjëse për veprimtarinë ekonomike, për të cilën jepet koncesioni.

2. Autoriteti kontraktues për koncesionet vendore është autoriteti përgjegjës i njësive të qeverisjes vendore.

3. Këshilli i Ministrave përcakton autoritetin kontraktues për çdo koncesion, pas identifikimit të koncesioneve të mundshme, sipas nenit 9 të këtij ligji.

4. Këshilli i Ministrave miraton rregullat e vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve, për plotësimin e qëllimit dhe zbatimin e dispozitave të këtij ligji, si dhe dokumentet standarde në fushën e koncesioneve.

Neni 6

Mbikëqyrja e zbatimit të procedurave koncesionare (Shfuqizohet)***

1. Mbikëqyrja e zbatimit të procedurave koncesionare dhe shqyrtimi administrativ i ankesave ndaj tyre bëhen nga Agjencia e Prokurimit Publik.

2. Në ushtrim të funksioneve për koncesionet, Agjencia e Prokurimit Publik ka këto kompetenca:

- a) u kërkon autoriteteve kontaktuese raportime periodike, një herë në 6 muaj, për gjendjen e koncesioneve;
- b) verifikon zbatimin e procedurave koncesionare, në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera të dala në zbatim të tij, duke u kërkuar autoriteteve koncesionare të gjithë informacionin e nevojshëm;
- c) propozon masa disiplinore dhe vendos gjopa në masën e përcaktuar në legjislacionin e prokurimeve, në rastet kur vëren shkelje të procedurave të këtij ligji;
- ç) bën shqyrtimin administrativ të ankesave të ofertuesve në lidhje me procedurat e koncesionit;
- d) vendos dhe shpall përjashtimin nga procedurat koncesionare të ofertuesve, që gjatë një procedure koncesionare kanë depozituar dokumente false apo kanë deklaruar informacion të rremë;
- dh) i jep Këshillit të Ministrave mendim për procedurën e ndjekur për koncesionet.

Neni 7

Mbrojtja e interesave ligjorë të ofertuesve

1. Monitorimi i zbatimit të këtij ligji dhe i akteve nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të tij, gjatë kryerjes së procedurave koncesionare, në mbrojtje të interesave të ligjshëm të ofertuesve, bëhet nga Avokati i Prokurimeve.
2. Në ushtrimin e funksioneve sipas këtij ligji, Avokati i Prokurimeve ka këto kompetenca:
 - a) shqyrton ankesat e personave të interesuar, për veprime apo mosveprime të kundërligjshme të autoritetit kontraktues;
 - b) fillon hetimin e procedurave administrative, kur vëren se rasti përbën shkelje të këtij ligji;
 - c) në përfundim të hetimit të procedurave administrative informon autoritetin kontraktues dhe Agjencinë e Prokurimit P ublik për rezultatet e hetimit.
3. Avokati i Prokurimeve, brenda 5 ditëve nga fillimi i hetimit, njofton personat e interesuar dhe Agjencinë e Prokurimit Publik për këtë fakt.
4. Gjatë ushtrimit të funksioneve për hetimin e procedurave administrative, Avokati i Prokurimeve mund:
 - a) të këqyrë në vend akte dhe dokumente, që kanë lidhje me çështjen në hetim;
 - b) të kërkojë informacione dhe shpjegime nga administrata shtetërore apo të marrë në pyetje çdo person të lidhur me çështjen në hetim, si dhe të kërkojë ekspertizë nga të tretët;
 - c) të rekomandojë ndryshimin e ligjit dhe akteve të dala në zbatim të tij, kur vëren se përmbajtja e këtyre akteve krijon mundësi për shkeljen e procedurave koncesionare.

Neni 8

Njësia e Trajtimit të Koncesioneve

Njësia e Trajtimit të Koncesioneve ngrihet në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë, për të nxitur dhe asistuar autoritetin kontraktues në vlerësimin dhe negocimin e

koncesioneve.

KREU II

IDENTIFIKIMI I KONCESIONEVE TË MUNDSHME DHE PËRZGJEDHJA E KONCESIONARIT

Neni 9

Identifikimi i koncesioneve të mundshme

1. Identifikimi i koncesioneve të mundshme bëhet nga ministritë përgjegjëse ose organet e njësisë të qeverisjes vendore, në bashkëpunim me Njësinë e Trajtimit të Koncesioneve. Koncesionet e mundshme mund të identifikohen edhe nga një propozues, nëpërmjet propozimeve të pakërkuara, në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 23 të këtij ligji.
2. Ministritë përgjegjëse ose organet e njësisë të qeverisjes vendore, me asistencën e Njësisë së Trajtimit të Koncesioneve, kryejnë analizën e rentabilitetit dhe të përshtatshmërisë financiare, për të gjykuar nëse duhet të zbatohet një koncesion i mundshëm. Kjo analizë bazohet në parimet e vlerës për para, në përputhshmërinë e koncesioneve të mundshme me objektivat strategjike kombëtare dhe objektivat strategjike të sektorit, në rentabilitetin teknik dhe tregtar të koncesionit të mundshëm dhe aftësinë e tij për të tërhequr koncesionarë të mundshëm dhe financime private.

Neni 10

Fazat e përzgjedhjes

1. Koncesionarët përzgjidhen nëpërmjet një procedure parakualifikuese, që shoqërohet me një kërkesë për propozim, të parashikuar në nenet 11 deri 21 të këtij ligji. Përjashtim nga ky rregull bëjnë koncesionet e dhëna sipas pikës 2 të këtij neni dhe nenit 23 të këtij ligji.
2. Pavarësisht nga përcaktimi i bërë në pikën 1 të këtij neni, autoriteti kontraktues ka të drejtë të kërkojë propozime nga të gjithë ofertuesit e mundshëm, pa një procedurë parakualifikuese, nëse e vlerëson se nuk është e nevojshme kryerja në këtë rast e procedurës parakualifikuese.

Neni 11

Procedura parakualifikuese

1. Autoriteti kontraktues përgatit ftesën për pjesëmarrje në procedurën parakualifikuese dhe dokumentet e parakualifikimit, me qëllim identifikimin e ofertuesve, që kanë kualifikimin e nevojshëm për të zbatuar koncesionin.
2. Ftesa për të marrë pjesë në procedurën parakualifikuese botohet në Buletinin e Njoftimeve

Publike, si dhe në shtypin ndërkombëtar dhe vendas.

3. Ftesa për të marrë pjesë në procedurën parakualifikuese përfshin këto të dhëna:

- a) një përshkrim të shkurtër të mjetit infrastrukturor;
- b) tregues për elementet thelbësore të koncesionit, si shërbimet që duhet të bëhen nga koncesionari, mënyrat e financimit të koncesionit, të parashikuara nga autoriteti kontraktues (për shembull, fondet që do të përdoren, nëse janë tërësisht nga tarifat ose pagesat e përdoruesve, apo koncesionarit mund t'i jepen fonde publike, të tilla si pagesa të drejtpërdrejta, hua ose garanci);
- c) një përmbledhje të kushteve kryesore, nëse ka të tilla, të kontratës koncesionare që do të lidhet;
- ç) mënyrën dhe vendin e paraqitjes së aplikimit për fazën parakualifikuese, si dhe afatin ligjor për dorëzimin, të shprehur në datën dhe orën e caktuar, duke u dhënë kohë të mjaftueshme ofertuesve për të përgatitur dhe dorëzuar aplikimet e tyre;
- d) mënyrën dhe vendin e marrjes së dokumenteve të fazës parakualifikuese.

Neni 12

Dokumentet e fazës parakualifikuese

Në dokumentet e parakualifikimit përfshihen të paktën:

- a) kriteret parakualifikuese, në përputhje me nenin 13 të këtij ligji;
- b) pjesëmarrja e bashkimit të përkohshëm të shoqërive, në përputhje me nenin 14 të këtij ligji;
- c) çdo kërkesë për domosdoshmërinë për të krijuar një person juridik nga ofertuesi i shpallur fitues, sipas ligjeve në fuqi.

Neni 13

Kriteret parakualifikuese

1. Ofertuesit e interesuar për të marrë pjesë në një procedurë përzgjedhëse duhet të plotësojnë disa kriteret objektive, të cilat autoriteti kontraktues i vlerëson të nevojshme për një procedurë të caktuar.

Kriteret përfshijnë të paktën:

- a) kualifikimet profesionale dhe teknike, burimet njerëzore, makineritë dhe asetet e tjera të nevojshme, për të kryer të gjitha fazat e projektit koncesionar, përfshirë projektimin, ndërtimin, operimin dhe, kur është e nevojshme, edhe mirëmbajtjen;
- b) aftësitë e mjaftueshme për të administruar fondet financiare të projesit dhe aftësinë për të financuar projektin;
- c) kapacitetet e duhura administruese dhe organizative, besueshmërinë dhe përvojën në zhvillimin e projekteve të ngjashme.

2. Ofertuesit e interesuar kualifikohen për të marrë pjesë në procedurë përzgjedhëse, kur:

- a) nuk janë subjekt i një procedure falimentimi, likuidimi, administrimi të kontrollueshëm apo përfundimi të veprimtarisë ose i çdo situatë tjetër që, sipas ligjeve në fuqi, sjell si pasojë procedura të të njëjtit karakter;
- b) nuk janë shpallur fajtorë për paraqitjen e dokumenteve të rreme.

Neni 14

Pjesëmarrja e bashkimit të përkohshëm të shoqërive

1. Autoriteti kontraktues, para se t'i ftojë ofertuesit në fazat përzgjedhëse, duhet t'i lejojë ata të formojnë bashkime të përkohshme shoqërish. Përveçse kur në dokumentet e parakualifikimit parashikohet ndryshe, të dhënat e kërkuara për anëtarët e bashkimit të përkohshëm të shoqërive, për kualifikimet e tyre, në përputhje me parashikimet e këtij neni, duhet t'i referohen bashkimit të përkohshëm të shoqërisë, në tërësi dhe anëtarëve të tij, në veçanti.
2. Secili anëtar i bashkimit të përkohshëm të shoqërisë mund të marrë pjesë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, vetëm në një bashkim të përkohshëm shoqërish në të njëjtën kohë. Shkelja e kësaj dispozite sjell skualifikimin e bashkimit të përkohshëm të shoqërisë dhe të anëtarit të këtij bashkimi shoqërish.

Neni 15

Vendimi për parakualifikimin

Autoriteti kontraktues bën kualifikimin e secilit ofertues, që ka paraqitur aplikimin në fazën e parakualifikimit, në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentet e parakualifikimit. Autoriteti kontraktues shpall listën e ofertuesve të parakualifikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit. Të gjithë ofertuesit e parakualifikuar ftohen për të paraqitur propozimet, në përputhje me nenet 16 deri 21 të këtij ligji.

Neni 16

Procedurat për propozimet e kërkuara

1. Procedurat për propozimet e kërkuara zhvillohen me një ose dy faza.
2. Autoriteti kontraktues, kundrejt pagimit të tarifës që mund të aplikojë, u jep ofertuesve të parakualifikuar kërkesën për propozim dhe dokumentet e tjera përkatëse, në përputhje me nenin 5 të këtij ligji, apo dokumente të tjera, që gjykohen të nevojshme. Në rast se procedurat e parakualifikimit nuk zbatohen, kërkesa për propozim u bëhet të gjithë ofertuesve të mundshëm.
3. Pavarësisht nga sa më sipër, autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurën me dy faza, për të kërkuar propozime nga ofertuesit, nëse elemente të tilla të projektit të koncesionit, si specifikimet e projektit, treguesit e performancës, mënyrat e financimit apo kushtet kontraktuale nuk mund të përshkruhen në kërkesën për propozim në mënyrë aq të

hollësishme dhe të saktë, që të lejojnë ofertuesit për të paraqitur propozimet e tyre përfundimtare.

4. Nëse vendoset procedura me dy faza, zbatohen këto dispozita:

- a) kërkesa fillestare për propozime u kërkon ofertuesve të paraqesin, në fazën e parë të procedurës, propozimet fillestare për specifikimet e projektit, treguesit e performancës, kërkesat financiare ose karakteristika të tjera të projektit, si dhe termat kryesorë kontraktualë, të propozuar nga autoriteti kontraktues;
- b) autoriteti kontraktues mund të organizojë takime dhe diskutime me çdo ofertues, për të sqaruar çështje në lidhje me kërkesën fillestare, për propozimet ose propozimet fillestare dhe dokumentet përkatëse të paraqitura nga ofertuesit. Autoriteti kontraktues pasqyron në procesverbale çdo takim apo diskutim për këtë çështje. (Procesverbali përmban çështjet e ngritura dhe sqarimet e dhëna nga autoriteti kontraktues);
- c) pas shqyrtimit të propozimeve, autoriteti kontraktues mund ta rishohë dhe ta ndryshojë çdo kërkesë fillestare për propozime, duke hequr apo përshtatur çdo aspekt të specifikimeve fillestare të projektit, treguesit e performancës, kërkesat financiare ose karakteristika të tjera të projektit, përfshirë kushtet kryesore kontraktuale dhe çdo kriter për vlerësimin, krahasimin e propozimeve dhe për caktimin e ofertuesit më të mirë, apo mund të shtojë karakteristika ose kriteret të tjera. Autoriteti kontraktues shënon në regjistrin e koncesioneve arsyet për çdo rishikim të kërkesës për propozim. Çdo shfuqizim, ndryshim apo shtesë duhet të pasqyrohet në ftesën për të paraqitur propozimet përfundimtare;
- ç) në fazën e dytë të procedurës, autoriteti kontraktues fton ofertuesit për të paraqitur propozimet përfundimtare për një paketë të vetme specifikimesh të projektit, të treguesve të performancës ose kushteve kontraktuale, në përputhje me nenet 17 deri 21 të këtij ligji.

Neni 17

Përmbajtja e kërkesës për propozim

Kërkesa për propozim, e përgatitur nga autoriteti kontraktues, përmban, të paktën, të dhënat e mëposhtme:

- a) të dhëna të përgjithshme, me qëllim që ofertuesit të përgatisin dhe të paraqesin propozimet e tyre;
- b) specifikimet e projektit dhe treguesit e performancës, sipas rastit, përfshirë edhe kërkesat e autoritetit kontraktues për standardet e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- c) kushtet kontraktuale, të propozuara nga autoriteti kontraktues, përfshirë treguesit për kushtet e panegociueshme;
- ç) kriteret që do të zbatohen për vlerësimin e propozimeve dhe, nëse do të zbatohen, edhe kufijtë minimalë për vlerësimin e propozimeve, peshën përkatëse të çdo kriteri dhe mënyrën, sipas së cilës kriteret dhe kufiri minimal duhet të zbatohen në vlerësimin dhe skualifikimin e propozimeve;
- d) kërkesat për garancinë e ofertës.

Neni 18

Sqarimet dhe modifikimet

1. Autoriteti kontraktues, me nismën e vet apo si rezultat i një kërkesë për sqarim nga një ofertues, mund të rishohë dhe, sipas rastit, të ndryshojë çdo element të kërkesës për propozim, sipas nenit 17 të këtij ligji.

Çdo ndryshim u njoftohet menjëherë të gjithë kandidatëve, që kanë tërhequr dokumentet e garës. Kur autoriteti kontraktues e vlerëson të nevojshme të ndryshojë dokumentet dhe kjo bëhet brenda një periudhe kohe më pak se 1/3 e numrit të ditëve të përcaktuara për përgatitjen e ofertave, duhet ta shtyjë afatin e fundit të paraqitjes së ofertave për të njëjtën periudhë kohe.

2. Autoriteti kontraktues, në rastin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, shënon në regjistrin e koncesioneve arsyet për çdo rishikim në kërkesën për propozim. Çdo shfuqizim, ndryshim apo shtesë u komunikohet ofertuesve në të njëjtën mënyrë si kërkesa për propozim.

Neni 19

Kriteret e vlerësimit

1. Kriteret për vlerësimin dhe krahasimin e propozimeve teknike përfshijnë të paktën:

- a) qëndrueshmërinë teknike;
- b) përputhjen me standardet e mjedisit;
- c) efikasitetin në veprim;
- ç) cilësinë e shërbimeve dhe të masave, për të siguruar vazhdimësinë e tyre;
- d) potencialin e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik, që ofrohet nga propozimet.

2. Kriteret për vlerësimin dhe krahasimin e propozimeve financiare dhe tregtare, sipas rastit, përfshijnë të paktën:

- a) vlerën aktuale të tarifave dhe të çmimeve për njësi të propozuara dhe pagesa të tjera gjatë periudhës koncesionare;
- b) vlerën aktuale të pagesave të drejtpërdrejta të propozuara, të bëra nga autoriteti kontraktues, nëse ka;
- c) shpenzimet për projektin dhe veprimtaritë e ndërtimit, shpenzimet për operimin dhe mirëmbajtjen vjetore, vlerën e tashme të investimeve, të shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes;
- ç) masën e mbështetjes financiare, nëse ka, që pritet të realizohet nga ndonjë autoritet publik i Republikës së Shqipërisë;
- d) qëndrueshmërinë dhe rentabilitetin e financimeve të propozuara.

3. Këshilli i Ministrave, për efekt të zbatimit të pikës 3 të nenit 4 të këtij ligji, përcakton edhe

kritere të tjera, që do të merren parasysh në vlerësimin e ofertave. Këto kritere bazohen në rëndësinë sektoriale të zhvillimit të ekonomisë, vlerën e investimit, nivelin e punësimit, përparësinë për zhvillimin e zonave të veçanta të vendit, tregues të tjerë specifikë të sektorëve, si dhe çmimin apo tarifën e propozuar. Këshilli i Ministrave, në këtë rast, përcakton dhe peshën që do të këtë çdo kriter në vlerësimin e ofertës.

Neni 20

Krahasimi dhe vlerësimi

1. Autoriteti kontraktues krahason dhe vlerëson çdo propozim, në përputhje me kriteret e vlerësimit, peshën relative, që i jepet çdo kriteri në procesin e vlerësimit, të parashikuar në kërkesën për propozim.
2. Për qëllimet e pikës 1 të këtij neni, autoriteti kontraktues mund të vendosë kufij minimalë për cilësinë, aspektet teknike, financiare dhe tregtare. Propozimet, që nuk arrijnë kufijtë minimalë, vlerësohen të papërshtatshëm dhe skualifikohen.

Neni 21

Caktimi i ofertuesit më të mirë dhe negociimet përfundimtare

1. Autoriteti kontraktues rendit të gjitha propozimet e pranueshme, në bazë të kriterëve të vlerësimit dhe njofton ofertuesit për këtë. Pas njoftimit, të gjithë ofertuesit kanë të drejtë të paraqesin ankesat e tyre, në përputhje me dispozitat e kreut III të këtij ligji. Me mbarimin e afatit për paraqitjen e ankesave, autoriteti kontraktues fton ofertuesin, që ka marrë vlerësimin më të mirë, për negociime përfundimtare.
2. Kushtet kontraktuale, të deklaruara të panegociueshme në kërkesën përfundimtare për propozime, nuk do të jenë objekt i negociimeve përfundimtare.
3. Nëse për autoritetin kontraktues, brenda një afati të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, bëhet e qartë se negociimet me ofertuesin e ftuar nuk do të përfundojnë me një kontratë koncesionare, ai i ndërpret negociimet me këtë ofertues dhe fton ofertuesit e tjerë, sipas renditjes, derisa të arrihet lidhja e kontratës së koncesionit, ose i refuzon të gjitha propozimet e mbetura. Autoriteti kontraktues nuk mund të rifillojë negociime me një ofertues, me të cilin negociimet janë ndërprerë, në përputhje me këtë pikë.
4. Pas përfundimit të negociimit për kontratën koncesionare, Njësia e Trajtimit të Koncesioneve, brenda 45 ditëve, jep mendim me shkrim për kushtet e kontratës. *Pas marrjes së mendimit dhe nënshkrimit, kontratat koncesionare me vlere investimi mbi 20 milion euro paraqiten për miratim në Këshillin e Ministrave. Kontratat koncesionare me vlere nën 20 milion euro hyjnë në fuqi pas nënshkrimit nga autoriteti kontraktues.
5. Autoriteti kontraktues boton në Buletinin e Njoftimeve Publike emrin e koncesionarit dhe kushtet thelbësore të kontratës së koncesionit brenda 30 ditëve pas miratimit të saj, në përputhje me përcaktimin e pikës 4 të këtij neni.

Neni 22

Negocimi i kontratave koncesionare pa procedura konkurruese

1. Autoriteti kontraktues mund të bëjë negocimin e kontratave koncesionare pa procedura konkurruese vetëm me miratimin e Këshillit të Ministrave, nëse:

a) projekti ndikon në cenimin e sigurisë kombëtare. Rastet e cenimit të sigurisë kombëtare, si rezultat i zbatimit të procedurave konkurruese, miratohen me vendim të Këshillit të Sigurisë Kombëtare;

b) kontrata koncesionare është zgjidhur për shkak të një shkeljeje serioze nga ana e koncesionarit dhe kur procedura konkurruese nuk është e mundur të realizohet, për shkak të nevojës urgjente për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë.

*c) për shkak të një shkeljeje serioze nga koncesionari kërkohej nga institucionet financiare, në bazë të së drejtës për të nderhyrë, zëvendesimi I koncesionarit.

2. Kohëzgjatja e një kontrate koncesioni, të lidhur sipas shkronjës "b" të pikës 1 të këtij neni, nuk duhet të kalojë 12 muaj.

3. Asnjë kontratë koncesionare nuk mund të realizohet sipas shkronjës "b" të pikës 1 të këtij neni, përveçse kur autoriteti kontraktues ka filluar një procedurë konkurruese përzgjedhëse për koncesionarin, në përputhje me kushtet e kontratës, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, apo kur ka vendosur të mos e japë koncesionin, me kalimin e afatit të përcaktuar në kushtet e kontratës.

4. Nëse një kontratë koncesioni negociohet në përputhje me këtë nen, pa përdorur procedurën konkurruese, autoriteti kontraktues duhet të caktojë kriteret të arsyeshme vlerësimi për kërkesat e projektit, në bazë të të cilave do të vlerësohen dhe do të renditen propozimet.

5. Autoriteti kontraktues boton në Buletinin e Njoftimeve Publike emrin e koncesionarit dhe kushtet thelbësore të kontratës së koncesionit brenda 30 ditëve nga data e miratimit të kontratës së koncesionit nga Këshilli i Ministrave, përveç rasteve të përcaktuara në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni.

Neni 23

Propozimet e pakërkuara

1. Autoriteti kontraktues është i autorizuar të shqyrtojë dhe të pranojë propozimet e pakërkuara, në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë nen, me kusht që këto propozime të mos kenë të bëjnë me një projekt, për të cilin ka filluar ose është shpallur procedura e përzgjedhjes.

2. Procedurat për përcaktimin e pranueshmërisë së propozimeve të pakërkuara janë:

a) brenda 90 ditëve pas marrjes dhe shqyrtimit fillestar të propozimit të pakërkuar, autoriteti

kontraktues përcakton nëse projekti koncesionar paraqet interes publik dhe për këtë vë në dijeni propozuesin;

b) kur projekti koncesionar paraqet interes publik, autoriteti kontraktues fton propozuesin të paraqesë të dhëna të tjera të nevojshme për projektin e propozuar, për të bërë vlerësimin për kualifikimet e propozuesit dhe fizibilitetin teknik dhe financiar të projektit;

c) brenda 120 ditëve nga ftesa e autoritetit kontraktues, propozuesi duhet të paraqesë një studim fizibiliteti teknik dhe financiar (duke përfshirë, por pa u limituar në të, një model financiar dhe një plan për financimin e projektit), një studim për ndikimin në mjedis dhe të dhëna të mjaftueshme për konceptin ose teknologjinë e parashikuar në propozim;

ç) gjatë shqyrtimit të një propozimi të pakërkuar, autoriteti kontraktues respekton pronësinë intelektuale, sekretet tregtare ose të drejtat e tjera ekskluzive të parashikuara, që rrjedhin apo që përmenden në propozim. Informacionin e dhënë nga/ose në emër të propozuesit për propozimin e pakërkuar, autoriteti kontraktues nuk e përdor pa pëlqimin paraprak të propozuesit, për një periudhë prej 12 muajsh nga data e marrjes së këtij informacioni.

3. Fillimi i një procedure përzgjedhëse bëhet si më poshtë:

a) autoriteti kontraktues, brenda 6 muajve nga marrja e dokumentacionit, në përputhje me shkronjën "b" të pikës 2 të këtij neni, vendos për pranimin ose refuzimin e projektit të mundshëm koncesionar, që rrjedh nga propozimi i pakërkuar. Nëse propozimi i pakërkuar pranohet nga autoriteti kontraktues, ai fillon një procedurë përzgjedhëse konkurruese në përputhje me nenet 11 deri 21 të këtij ligji, ndërsa kur propozimi refuzohet dhe palët nuk bien dakord ndryshe, autoriteti kontraktues i kthen propozuesit dokumentet origjinale dhe fotokopjet e dokumenteve të paraqitura;

b) propozuesi ftohet të marrë pjesë në procedurën përzgjedhëse konkurruese, në përputhje me shkronjën "a" të pikës 3 të këtij neni dhe, me vendim të Këshillit të Ministrave, atij i jepet një bonus për rezultatin teknik dhe/ose financiar të arritur gjatë procedurës përzgjedhëse konkurruese deri në një maksimum 10 për qind të pikëve. Identiteti i propozuesit, ekzistenca dhe shuma e bonusit tregohen në dokumentet e procedurës përzgjedhëse konkurruese.

Neni 24

Konfidencialiteti

Autoriteti kontraktues ruan konfidencialitetin e të gjitha të dhënave teknike, ekonomike, financiare etj. të propozimeve të bëra nga ofertuesit. Nëse nuk parashikohet me ligj, me vendim gjykatë apo në kërkesën për propozim, palët në bisedime nuk i deklarojnë personave të tjerë informacione teknike, të dhëna për çmimin dhe elemente për diskutimet, komunikimet dhe bisedimet, në përputhje me dispozitat e mësipërme, pa pëlqimin e palës tjetër.

KREU III

PROCEDURAT E RISHIKIMIT ADMINISTRATIV

***Neni 24/1

Agjensia e Konkensioneve

1. Agjensia e konkensioneve eshte person juridik public buxhetor, ne varesi te Kryeministrit, qe funksionon ne baze te ketij ligji.
2. Keshilli I Ministrave percakton me vendim menyren e organizimit dhe te funksionimit te Agjensise te Konkensioneve.
3. agjensia e Konkensioneve, ne ushtrim te funksioneve te saj, ka keto kompetenca:
 - a) mbikqyr zbatimin e procedurave konkensionare dhe ben shqyrtimin administrative te ankesave ndaj ketyre procedurave;
 - b) verifikon zbatimin nga ana e autoritetit kontraktues te procedurave te konkensionit, sipas ketij ligji dhe akteve te tjera te dala ne zbatim te tij, duke u kerkuar autoriteteve konkensionare te gjithë informacionin e nevojshem;
 - c) ben shqyrtimin administrative te ankesave te ofertuesve per procedurat e konkensionit;
 - ç) propozon masa disiplinore dhe vendos gjoba per personat e ngarkuar nga autoriteti kontraktues me hartimin e dokumentave, zbatimin e procedures parakualifikuese, vleresimin e kriterëve, perzgjedhjen e ofertave dhe negociimin e kontrates, sipas rregullave te konkensionit, ne masen e percaktuar ne legjislacionin e konkensioneve, ne rastet kur veren shkelje te procedurave rre ketij ligji;
 - d) vendos dhe shpall perjashtimin nga procedurat konkensionare te ofertuesve, te cilet, gjate nje procedure konkensionare, kane depozituar dokumente false, ose kane deklaruar informacion te rreme, si dhe, kur eshte rasti, ben kallzim penal;
 - dh) mbyll hetimin administrativ dhe, kur pranon ankimin , per shkeljet e konstatuara ne proceduren e konkensioneve, propozon masat perkatese per rregullimin ose anullimin e tyre;
 - e) mban dhe administron rregjistrin e konkensionit, si dhe dokumentacionin original qe dergohet nga autoritetet kontraktuese Brenda 3 muajve nga data e miratimit te kontrates se konkensionit;
 - ë) u kerkon autoriteteve kontraktueseraportime periodike 1 here ne 6 muaj per gjendjen e konkensioneve dhe, bazuar ne ceshtjet e raportuara dhe te shyrtuara, I paraqet Keshillit te ministrave rekomandime te pergjithshme per gjendjen dhe per kuadrin ligjor te konkensioneve.

Neni 25

Procedura e ankimit

1. Çdo ofertues mund të kërkojë rishikim administrativ të procesit të përzgjedhjes, kur gjykon se një veprim i ndërmarrë nga autoriteti kontraktues është në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji apo të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore për procedurat e koncesionit.

2. Ankesa paraqitet tek Agjencia e Prokurimit Publik brenda 5 ditëve kalendarike nga data e botimit të njoftimit të kandidatëve të parakualifikuar apo e njoftimit të renditjes së ofertuesve nga autoriteti kontraktues.

3. Me marrjen e ankesës, Agjencia e Prokurimit Publik njofton brenda 5 ditëve autoritetin kontraktues në lidhje me pezullimin e procedurave koncesionare dhe fillimin e procedurave të hetimit administrativ.

4. Agjencia e Prokurimit Publik nuk pezullon procedurën koncesionare në rastet kur:

a) nga shqyrtimi paraprak rezulton se ankesa nuk është e argumentuar juridikisht;

b) pezullimi vjen në kundërshtim me interesin publik apo dëmton autoritetin kontraktues ose ofertuesit e tjerë.

5. Gjatë shqyrtimit të ankesës, deri përpara lidhjes së kontratës, Agjencia e Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të shfuqizojë pjesërisht apo plotësisht vendimet ose aktet e autoritetit kontraktues;

b) ta udhëzojë autoritetin kontraktues për korrigjimin e shkeljeve përpara vazhdimit të procedurave koncesionare.

***6. Agjencia e Konkencioneve, gjate procedurave te hetimit administrativ, ka te gjitha kompetencat e parashikuara ne kete ligj dhe ne aktet nenligjore te dala ne zbatim te tij.

7. Ankesa në Agjencinë e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkeljes. Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Agjencia e Prokurimit Publik e shqyrton ankesën, në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore të dala në zbatim të tij dhe Kodin e Procedurave Administrative.

***7/1. Cdo ankese ne Agjensine e Konkencioneve, qe merret ne shqyrtim nga kjo e fundit, duhet te shoqerohet me pagesen paraprake prej 10% te vleres se garancise se ofertes.

Moskryerja e pageses paraprake perben shkak per mosfillimin e shqyrtimit te ankeses. Kjo pagese I kthehet subjektit kur, ne fund te procesit te ankimit, ankesa e tij pranohet ose kalon ne favor te buxhetit te shtetit, kur ankesa nuk pranohet. Forma dhe menyra e kryerjes se kesaj pagese percaktohen ne rregullat e koncensionit.

8. Agjencia e Prokurimit Publik, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së ankesës, përfundon hetimin administrativ dhe njofton autoritetin kontraktues dhe ankuesin për vendimin.

9. Vendimi i Agjencisë së Prokurimit Publik është akti administrativ përfundimtar.

***Neni 25/1

Procedura e hetimit administrativ

1. Agjensia e Konkencioneve fillon proceduren e hetimit administrativ mbi bazen e ankimit te nje apo me shume paleve pjesemarrese ne nje procedure koncensionit.

2. Agjensia e Konkencioneve, per te realizuar funksionet e saj, ka te drejte te kete akses ne cdo institucion te administrates publike, te cilat, sipas ketij ligji, njihen si autoritete

kontraktuese.

3. Agjensia e Konkencioneve ka te drejte te caktoje nje afat per informacionin qe duhet te jape autoriteti kontraktues, ne baze te kerkeses se saj, si dhe per dorezimin e dokumentave perkatese, sipas legjislacionit qe rregullon procedurat administrative.

***Neni 25/2

Perfundimi i hetimit administrativ

1. Agjensia e Konkencioneve, pas perfundimit te hetimit administrativ, merr keto vendime:
 - a) pranon ankimin e ankuesit, duke arsyetuar e argumentuar shkeljet e konstatuara ne zbatimin r ligjit e te procedurave per konkensionet, duke treguar masat perkatese per anulimin e tyre dhe rivendosjen e ligjshmerise ne veprimet e autoritetit kontraktues;
 - b) rrezon ankimin e pales, duke konstatuar zbatimin e procedurave dhe ligjshmerise per veprimet apo mosveprimet e paraqitura si shkelje nga ankimuesi, duke I sqaruar atij me shkrim arsyet e rrezimit te ankimit;
 - c) per shkeljet e konstatuara ne proceduren e konkencioneve e te ligjshmerise ne zbatimin e ligjit, I jep autoritetit kontraktor nje afat, Brenda te cilit ky I fundit eshte I detyruar ti ndreqe ato, ose te ndaloje efektin apo pasojat negative te ketyre shkeljeve.
2. Vendimi I dhene sipas pikes 1 te ketij neni eshte I ekzekutueshem. Ndaj tij palet mund te bejne ankim ne gjykate, sipas Kodit te Procedures Civile.

***Neni 25/3

Detyrimi per bashkepunim

Refuzimi I nepunesit civil, I funksionarit ose autoritetit kontraktues per te dhene informacion apo per te paraqitur dokumentacionin qe ka lidhje me procedurebn nen hetim administrative, perben shkak qe Agjensia te kerkoje nga autoriteti competent dhenien e masave disiplinore ndaj personave pergjegjes.

Neni 26

Ankimi në gjykatë

Kundër vendimit të Agjencisë së Prokurimit Publik, ankuesi ka të drejtë që, brenda 30 ditëve nga marrja dijëni, të bëjë padi për shqyrtim të mosmarrëveshjes administrative në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (seksioni administrativ).

Gjykata kryen shqyrtimin gjyqësor, sipas procedurave dhe brenda afateve të përcaktuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, kreu II, "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative".

Shqyrtimi i këtij ankimi në gjykatë nuk pezullon vazhdimin e procedurave të koncesionit.

***Neni 26/1

Kundravajtjet administrative

1. Shkelja e dispozitave të këtij ligji nga personat përgjegjes, kur nuk perben veper penale, perben kundravajtje administrative dhe denohet me gjobe nga 50-100 mije leke. Gjoba vendoset nga titullari I Agjensise se Konkencioneve. Kunder denimit me gjobe mund te behet ankim brenda 30 diteve ne gjykatën kompetente.
2. Titullari I Agjensise mund ti propozoje drejtuesit te autoritetit kontraktor, nese e gjykon te nevojshme, edhe marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjes qe shkelin dispozitat e këtij ligji.

KREU IV

KONTRATA KONCESIONARE

Neni 27

Përmbajtja

Kontratat e koncesionit parashikojnë ato çështje që vlerësohen të përshtatshme nga palët, të tilla si:

- a) natyra dhe objekti i punëve që duhet të kryhen dhe shërbimet që duhet të jepen nga koncesionari;
- b) kohëzgjatja e kontratës së koncesionit që përshtatet me specifikën e koncesionit përkatës, por që nuk i kalon 35 vjet dhe kushtet, nëse ka, për zgjatjen e saj. *Ne rast se afati është mbi 35 vjet, kontrata hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi.
- c) ndihma që mund t'i japë autoriteti kontraktues dhe njësia e trajtimit të koncesioneve koncesionarit për marrjen e licencave dhe të lejeve të nevojshme për koncesionin;
- ç) çdo kërkesë për themelimin dhe kapitalin themeltar të një personi juridik, që duhet të krijohet nga ofertuesi i shpallur fitues, në bazë të ligjeve në fuqi, si dhe ndalimin për transferimin e aksioneve apo të pjesëve të kapitalit të kësaj shoqërie, pa pëlqimin paraprak të autoritetit kontraktues;
- d) pronësia e aseteve të projektit të koncesionit dhe detyrimet e palëve, sipas rastit, për vënien në dispozicion të vendit të projektit të koncesionit dhe çdo lehtësi tjetër të mundshme;
- dh) shpërblimi i koncesionarit, pavarësisht nëse përbëhet nga tarifa apo pagesa për përdorimin e mjetit të infrastrukturës ose realizimit të shërbimeve, metodat dhe formulat për

caktimin ose rregullimin e këtyre tarifave apo pagesave, si dhe, nëse zbatohen, pagesat që mund të bëhen nga autoriteti kontraktues ose një autoritet tjetër publik, si dhe nëse ka detyrimin për pagesa që koncesionari duhet t'i bëjë autoritetit kontraktues;

e) procedurat për rishikimin dhe miratimin e projekteve inxhinierike, të planeve të ndërtimit dhe specifikimeve nga autoriteti kontraktues, si dhe procedurat për testimin dhe kontrollin përfundimtar, miratimin dhe pranimin e mjetit të infrastrukturës, rregullat dhe standardet, në bazë të të cilave janë projektuar projektet koncesionare, që duhet të jenë në përputhje me praktikën më të mirë, me synim zhvillimin e tregut nëpërmjet ndarjes së riskut;

ë) shtrirja e detyrimeve të koncesionarit, sipas rastit, për të siguruar ndryshimin e shërbimit, për të përmbushur kërkesat e kohës, vazhdimësinë e tij dhe dhënien, në kushte kryesisht të njëjta për të gjithë përdoruesit, mekanizmat për të trajtuar kostot e mundshme për to;

f) e drejta e autoritetit kontraktues ose e një autoriteti tjetër publik për të monitoruar punët që duhet të kryhen dhe shërbimet që duhet të jepen nga koncesionari, kushtet dhe masën, në të cilën autoriteti kontraktues mund të urdhërojë ndryshime për punët dhe kushtet e shërbimit. E drejta e autoritetit kontraktues për të marrë masa të tjera të arsyeshme, për të siguruar që mjeteve infrastrukturor të operohet si duhet dhe shërbimet të jepen në përputhje me kërkesat e zbatueshme ligjore dhe kontraktuale, si dhe e drejta për të monitoruar mekanizmat dhe trajtimin e shpenzimeve të mundshme për to;

g) detyrimet e koncesionarit për t'i dhënë autoritetit kontraktues apo një autoriteti tjetër publik, sipas rastit, raporte dhe informacion tjetër për veprimtarinë;

gj) çdo kufizim ose kusht të zbatueshëm për transferimin e të drejtave dhe të detyrimeve të koncesionarit, sipas kontratës së koncesionit;

h) çdo kufizim ose kusht për transferimin e një interesi kontrollues të koncesionari;

i) përkufizimi dhe pasoja e forcës madhore, ndryshimi në ligj dhe ndryshime të tjera në rrethana (duke përfshirë çdo të drejtë të palëve për të kërkuar kompensimin ose rishikimin e kontratës së koncesionit);

j) detyrimet e mundshme, nëse ka, të autoriteteve publike përkatëse ose të autoritetit kontraktues;

k) rrethanat, në të cilat autoriteti kontraktues ka të drejtën të marrë përsipër, përkohësisht, administrimin e mjetit të infrastrukturës, për sigurimin e një shërbimi të efektshëm dhe të pandërprerë dhe, në rastin e dështimit nga koncesionari, të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale dhe të dështimit të tij, për të rregulluar shkeljen e kontratës;

l) çdo të drejtë të autoritetit kontraktues për të rishikuar dhe miratuar kontratat kryesore, që duhet të lidhen nga koncesionari, veçanërisht me aksionerët e koncesionarit ose persona të tjerë juridikë, ku koncesionari është pjesëmarrës apo anasjelltas;

ll) garancitë për t'u përmbushur dhe politikat e sigurimeve që duhet të ndiqen nga koncesionari për zbatimin e koncesionit;

m) procedurat e rregullimit të shkeljes së kontratës, të bërë nga njëra prej palëve;

n) kushtet dhe procedurat për ndryshimin dhe/ose përfundimin e kontratës; të drejtat dhe detyrimet e palëve, me kalimin e afatit apo përfundimin e kontratës (duke përfshirë mekanizmin e transferimit të sendeve pasurore, të teknologjisë, kompensimit, shërbimit e

- trajnimin dhe të mbështetjes që duhet të jepet nga koncesionari);
- nj) ligji i zbatueshëm dhe mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit;
- o) të drejtat dhe detyrimet e palëve për informacionin konfidencial.
- *p) të drejtën e nderhyrjes së financuesve.

Neni 28

Zgjidhja e kontratës së koncesionit

1. Autoriteti kontraktues, nëse nuk parashikohet ndryshe në kontratën e koncesionit, mund ta zgjidhë kontratën kur:
 - a) ka arsye të mendojë se koncesionari nuk do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet, për shkak të paaftësisë paguese, shkeljeve serioze apo të rasteve të tjera që pengojnë apo nuk bëjnë të mundur vazhdimin e kontratës së koncesionit;
 - b) koncesionari dështon në sigurimin e financimit të projektit brenda 12 muajve nga nënshkrimi i kontratës së koncesionit.
2. Secila palë, nëse nuk është parashikuar ndryshe në kontratën e koncesionit, ka të drejtë ta zgjidhë kontratën kur:
 - a) përmbushja e detyrimeve bëhet e pamundur, për shkak të rrethanave që kanë qenë jashtë kontrollit të arsyeshëm të secilës palë;
 - b) ka shkelje serioze nga pala tjetër e kur kjo palë nuk mund ta korrigjojë këtë shkelje brenda afatit kohor dhe sipas mënyrës së parashikuar në kontratën e koncesionit.
3. Palët kanë, gjithashtu, të drejtë ta zgjidhin kontratën e koncesionit me pëlqim të dyanshëm.

KREU V

FINANCIMI

Neni 29

Masat financiare

1. Koncesionari ka të drejtë të vendosë, të marrë ose të mbledhë tarifa apo të ardhura të tjera për përdorimin e aseteve ose të shërbimeve të realizuara prej tij, në përputhje me kontratën e koncesionit, e cila parashikon mënyrat dhe formulat e caktimit e të ndryshimit të këtyre tarifave ose pagesave.
2. Autoriteti kontraktues ka të drejtë t'i bëjë koncesionarit pagesa të drejtpërdrejta, si zëvendësim apo si shtesë e tarifave ose pagesave për përdorimin e aseteve ose të shërbimeve të realizuara prej tij.

KREU VI ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE DHE LIGJI I ZBATUESHËM

Neni 30 Ligji i zbatueshëm

1. Kontrata e koncesionit u nënshtrohet ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
2. Koncesionari, aksionarët e tij dhe ortakët e tjerë të veprimtarisë së tij ekonomike janë të lirë të zgjedhin ligjin që rregullon marrëdhëni et ndërmjet tyre.

Neni 31 Mosmarrëveshjet ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit zgjidhet me mekanizmat e përcaktuar në kontratën e koncesionit, për të cilët palët kanë rënë dakord, përfshirë edhe procedurat e arbitrazhit ndërkombëtar.
2. Koncesionari, aksionerët e tij dhe ortakët e tjerë të tij janë të lirë të zgjedhin mekanizmat e përshtatshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 32 Shfuqizime

Ligji nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 33 Periudha tranzitore deri në krijimin e Njësisë së Trajtimit të Koncesioneve

Deri në krijimin e Njësisë së Trajtimit të Koncesioneve, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji dhe bërjes së saj plotësisht operacionale, përgjegjësitë dhe kompetencat do t'i ushtrojë ministria përgjegjëse për ekonominë.

Neni 34

Ligjet ekzistuese për fusha specifike

1. Në rast mospërputhjeje me ligjet ekzistuese, ky ligj mbizotëron mbi të gjitha ligjet e tjera për koncesionet.
2. Të gjitha ligjet për sektorë të veçantë duhet t'i rregullojnë koncesionet në përputhje me këtë ligj.

Neni 35

Kontratat e koncesionit që janë nënshkruar

Ky ligj nuk zbatohet për kontratat e koncesionit, të nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Kontratat nuk mund të ripërsëriten ose të shtyhen, veçse në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 36

Kudo ne ligj, emertimi “Agjensia e Prokurimit Publik” zëvendësohet me emertimin “Agjensia e Koncensioneve”.

Neni 37

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5179, datë 12.1.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

